

sikurse thotë dhe Akuini “rrënjën e gabimit” ose më mirë të themi duke shpjeguar me argumenta bindëse pse janë të gabuara dhe duke treguar të vërtetën e kundërshtuar. Të gjitha këto i bënte duke përdorur një ton shumë të edukuar, duke u ruajtur nga sulmet personale, prej të cilave kishte shumë frikë. Gjithçka e bënte duke u treguar i kujdesshëm ndaj dialektit të ideve dhe interesave të së mirës së përbashkët të vërtetësisë dhe të Kishës.

At Tomáš, në periudhën e vështirë të pas Konçilit, periudhë kjo shpeshherë “përparimtare” neomoderniste që në mënyrë të rremë kërkonte të zinte vendin e Konçilit, e ndjeu si Misionin e tij thirrjen për të kujtuar vlerat e Traditës që rrezikonin të harroheshin. Duke demaskuar mashtrimet e neomodernistëve ai punoi për të ardhmen duke theksuar me vendosmëri se e ardhmja ndërtohet vetëm mbi pasurinë e patundshme e të vlefshme të Traditës. Ndërkohë ai me shumë kujdes evitoi çdo “tradicionalizëm” duke treguar besnikëri të plotë ndaj Kishës edhe në periudhën e vështirë të pas Konçilit”.

Edhe në momentet e diskutimeve të tij të shumta, At Tomáš kurrë nuk e harroi kushtin e tij të meshtarit Dominikan, ai ishte i shqetësuar për të bërë mirë dhe për shenjtërimin e shpirtit, ndaj të qënurit të tij bari nuk mungoi kurrë, madje atëherë kur dukej se arsyetimi i tij ishte abstrakt dhe larg realitetit, pikërisht në ato momente ai bëhej plotësisht pjesë e reales, mbi të gjitha kur bëhej fjalë për Realitetin Hyjnor apo mbinatyror. Ai e dëshmon plotësisht realizmin dhe mbrohet mjaft mirë nga lojërat tërheqëse por të rrezikshme dialektike të idealizmit të cilat i kritikon vazhdimisht.

At Tomáš, ndonëse ishte një teolog virtuoz, ka ditur të durojë në qetësi moskuptimet që i vinin nga disa ambiente të vetës botës së krishterë katolike, nga persona që nuk ishin të aftë të kuptonin vlerën e mendimit të tij apo nga persona përkrahës të neomodernizmit të cilën vetë Tomáši e kundërshtonte me çdo argument.

Në masën me të cilën do të rëndohet çorientimi dhe relativizmi në fushën morale, ai do ta ndjejë gjithmonë e më tepër nevojën të rikthehet në mësimet e At Tyn, i cili me mendimin e tij të shëndetshëm dogmatik dhe spekulativ na kujton se një betejë efikase kundër gabimit në moral vjen si rrjedhojë e gabimeve dogmatike dhe spekulative që janë në bazë, duke propozuar në këtë mënyrë, me argumenta të vlefshme, doktrinën e shëndetshme.

Në këtë mënyrë historiani i famshëm i teologjisë, At Batista Mondin, përmbodhi “specifika e nevojave që

Tyn jep mbi metafizikën e qenies së Shën Tomazit” (Metafizika e Shën Tomazit nga Akuini dhe interpretuesit e tij, ESD, Bolognjë 2002, pp. 127-128):

“E para: originaliteti i metafizikës së tij qëndron në *ese-në* intensive që sipas Tyn nuk i kundërvihet doktrinës së përmbajtjes së aristotelit, por kuptohet si një koherencë zhvillimi”.

“E dyta: pikënisja e metafizikës së Shën Tomazit është i njëjti me metafizikën e Aristotelit: subjekti i tij nuk mund të jetë veçse enti si i tillë” dhe unë shtoj enti i ndjeshëm nga i cili, me vijueshmërinë e duhur induktive fitojmë nocionin e entit shpirtëror (personin) pra, Zotin, *ipsum Esse per se subsistens*, ashtu sikurse thotë dhe Shën Tomazi, krijuesi i entit.”.

“E treta: riabilitimi i esencës kundrejt “tomizmit ekzistencial të Gilson... ndërsa Gilson kërkon ta përjashtojë praninë e esencës së Zotit... Tyn nxjerr në pah se esenca është pjesë e strukturës origjinale të çdo enti, pra edhe e Substancës Hyjnore”.

Profesori i njohur Adrian Bausola, një ndër filozofët më të mëdhenj katolik të shekullit të shkuar, në “Prezantimin” e veprës së At Tyn, *Metafizika e substancës. Pjesmarrja dhe analogjia entis*, ESD, Bolognjë 2000, një vëllim me 972 faqe, shfaqej me këto fjalë: “Duke lexuar veprën imponuese të At Tyn, këtë vepër të cilin kam nderin ta prezantoj, fillimisht më vjen në mendje imazhi i një vegimi të bukur në shkretëtirë. Oazi (vegimi): një trajtim i kujdesshëm i metafizikës; shkretëtira: mendimi filozofik i kohës, kaq pak i besueshëm në arsyetim, kaq i sheshtë” (p.VII).

Kjo thirrje për ndërgjegjësim është në linjë të drejtë me një ndër temat e magjisterit të Papa Benedikti XVI: mbi këtë bazë të përbashkët të pasurisë së çdo njeriu, besimtar apo jo, të gjithë jemi të ftuar të ballafaqohemi përtë shpëtuar dinjitetin e njeriut, kafshë e arsyetueshme, për të përgatitur, sipas thirrjes së Batistit, “udhët e Zotit”.

Fr. Giovanni Cavalcoli, OP

Kush merr hire falë ndërmjetësimi të Shërbëtorit të Zotit, At Tomáš Tyn, është i lutur të informojë zëvendëspostullatorin e çështjes: At Giovanni Cavalcoli, OP, Convento di San Domenico, Piazza San Domenico 13, 40124 Bologna, Tel: 0039 0516400418, ose 0039 0516400411, e-mail: giocavg@libero.it

Për oferta të mundshme për të sponsorizuar publikime të ose mbi At Tomáš Tyn, t'i drejtoheni At Giovanni Cavalcoli, OP Convento di San Domenico, Piazza San Domenico 13, 40124 Bologna ose të derdhen në numrin e llogarisë bankare në favor të: ASSOCIAZIONE CENACOLO di SAN DOMENICO, Finalità: AMICI DI PADRE TOMÁŠ TYN O.P. Pranë Bankës Popullore në Emilia Romagna

Shërbëtori i Zotit At Tomáš Tyn OP



LUTJE PËR TË MARRË HIRE ME ANË TË NDËRMJETËSIMIT TË SHËRBËTORIT TË ZOTIT AT TOMÁŠ TYN OP

*At i shenjtë, e plot mëshirë, ti që dërgove Fjalën tënde në botë për ta udhëhequr nga errësira në dritë. Të falenderojmë për dhuratat e Shpirtit tënd që ia dhe shërbëtorit tënd at Tomáš Tyn. denjohu ta lartësosh në nderet e altarit, që dëshmia shembullore të cilën na e ka dhënë si bir I denjë i Atit të shenjtë Dominik dhe e së Lumes Virgjërës Mari, të jetë shembull për të gjithë në ndjekjen e Krishtit dhe me ndërmjetësimin e tij na jep hirin që ta kërkojmë. Nëpër Krishtin, Zotin tonë. Amen.
Ati ynë.... Të falemë Mari... Lavdi Atit...*

Jeta e At Tomáš Týn

Tomáš lindi më 3 maj 1950 në Brno, në Çekoslovakia, që sot njihet si Republika Çeke. Vogëlushi Tomáš që i vogël i fitoi nga familja principet e krishtera të cilat në atë kohë regjimi komunist i pengonte duke ndaluar shfaqjen e besimit në publik. Administratori i famullisë, Don Jozef Budish, ishte personi që ndikoi më tepër në formimin e krishterë të vogëlushit. Që në moshën 12 vjeçare Tomáš filloi të shprehë dëshirën për t'u bërë meshtar rregulltar, edhe pse nëna e këshillonte të bëhej mjek.

Me të mbaruar me sukses kurset shkollore të fillores dhe shkollës së mesme, pikërisht në qytetin e lindjes, falë një burse studimi frekuentoi Akademinë e Dixhione dhe Liceun Carnot në Francë, të cilën e përfundoi më 1 korrik të 1969 me nota të shkëlqyeshme. Aty pati kontakte me At Domenikon Henri – Marie Fèret. Në këtë periudhë mësoi shumë mirë disa gjuhë të huaja: rusisht, frëngjisht, gjermanisht, hebraisht, greqisht dhe latinisht. Ndërkohë, më 1968, për shkak të pushtimit sovietik, prindërit e tij u larguan nga Çekosllovakia dhe gjetën strehim në Gjermaninë Perëndimore.

Me të lënë Francën, Tomáš shkoi të banojë në Gjermani, pas 28 shtatorit 1969 mori Veshjen e Urdhërit të Predikuesve në Warburg, në Vestfalia, ku edhe bëri noviciatin. At Tomáš u emërua pedagog i teologjisë morale dhe fjala e tij e shkëlqyeshme shoqëron shfaqjen e argumentuar dhe bindëse të doktrinë së shenjtë ndaj gabimeve thelbësore që në atë kohë mbizotëronin në ambjentet teologjike; ndonëse merrte ndonjë kundërshtim, At Tomáš me shumë guxim do vazhdojë ta përmbushi misionin e tij, me vetëdije për përgjegjësinë e tij ndaj Zotit dhe ndaj shpirtit.

Në vitin 1980 At Tomáš është zëvendës drejtues i Studimit Teologjik Akademik të Bolonjës. Predikues këmbëngulës dhe i zellshëm, në të njëjtën kohë bën një apostullat të ndryshëm e të shumëllojshëm në ambjente të ndryshme; afron jobesimtarë të cilët tërhiqen prej tij dhe fillojnë të besojnë në Kishën; me urtësi të madhe dhe kompetencë i kushtohet ministerit të pajtimit (rëfimit) dhe udhëheqjes së shpirtit, disa prej të cilave udhëhiqen prej tij drejt jetës së shuguruar, bën kurse e ushtrime të ndryshme shpirtërore dhe mban shumë konferenca. Përveç të tjerash, me impenjim të madh për shumë vite ushtron ministerin meshtarak të së Diellës pranë famullisë së

Bolonjës Shën Jakobi jashtë mureve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave shpirtërore të çiftve të martuara apo të fejuara.

Bashkëvëlla gjithmonë i disponueshëm, i shoqërueshëm, i besueshëm, i dashur, i përvujtë me një të folur të mprehtë dhe duke iu shmangur bisedimeve boshe At Tomáš e jetoi në plotësi jetën e tij si frat domenikan, duke zbatuar më së miri të gjitha rregullat. Ndërkohë ai nuk e fshihte lehtësimin dhe gëzimin në shëtitjet e bëra mes bukurive të natyrës. E dashuronte liturgjinë, lutjen dhe kundrimin, ishte i devotshëm ndaj Meshës së Shenjtë e në mënyrë të veçantë Eukaristisë; ndonëse e mikpriste mirë ritin e riformuar të Konçilit, atij i pëlqente që ndonjëherë të celebronte Meshën e Shenjtë sipas Shën Piu V dhe këtë e bënte për disa persona që e adhuronin atë liturgji.

Shumë i devotshëm ndaj Zojë së Bekuar dhe si Domenikan i mirë dhe ndaj Rruzares së Shenjtë, ishte admirues i përshtetërisë Mariane të Shën Luigji Maria Grignon nga Montfort, ndaj kur i jepej mundësia ua rekomandonte të tjerëve. At Tomáš, ashtu sikurse të gjithë sllavët, nuk kishte vetëm inteligjencë, por dhe ndjeshmëri artistike dhe ndjenjë e të bukurës: pëlqente letërsinë dhe muzikën klasike, duke treguar dhe aftësi të larta në këto lëndë. Merrte pjesë me dëshirë në diskutime të ndryshme mes shkencëtarëve, filozofëve dhe teologëve të cilat organizoheshin vazhdimisht nga miku i tij At Serxhio Parenti. Meqenëse ai ishte teolog i mirë kujdesej dhe për shkrimet e tij dhe publikimet e tyre në revista të specializuara.

Trupi i tij i shëndetshëm ra papritur, kur sapo kishte mbushur 39 vjeç, nga një sëmundje e tmerrshme dhe e pashërueshme që e çoi drejt varrit brenda një kohe të shkurtër dy mujore, mes vuajtjesh të cilat ai i duroi me heroizëm.

Muajin e fundit të sëmundjes At Tomáš e kaloi në Gjermani, nën kujdesin dhe dashurinë e prindërve, ndaj varri i tij gjendet në Neckagermünd. Edhe në muajin e fundit të jetës së tij, mes vuajtjesh të mëdha, At Tomáš gjeti forcën të celebronte Meshën në dhomën e tij.

Në ditët e fundit të jetës së tij At Tomáš i dorëzoi Botuesit domenikan At Vincenco Benetolo një vepër me vëllime metafizike, mbi të cilën kishte punuar prej dhjetë vitesh dhe që u botua më 1991.

Në Neckagermünd ai vdiq në datë 01 janar 1990, ndërsa në atdheun e tij bëhej kalimi nga një regjim

pushtues në demokraci: votat e tij ishin përmbushur! Këtu u bë dhe varrimi më 5 janar 1990.

Menjëherë pas vdekjes së tij të shenjtë, miq dhe njerëz të devotshëm në Itali dhe në Republikën Çeke, u bënë promovues të çështjes së tij të lumturimit. Këmbëngulja e tyre u vlerësua sepse më 25 shkurt 2006, në bazilikën domenikane të Shën Dominikut, arqipeshkëvi i asaj periudhe Kardinali Carlo Caffarra, inauguroi në mënyrë solemne hapjen e procesit të tij të lumturimit.

Mendimi i At Tomáš Týn

Mendimi i At Tomáš është një vision i bashkimit të doktrinës katolike të prezantuar në mënyrë sistematike si në aspektin teologjik ashtu dhe në atë filozofik, në shkollën e Shën Tomaz Akunit.

Temat kryesore të thelluara dhe të ilustruara nga Shërbëtori i Zotit janë Doktrina e Hyjit Një, Misteri i Trinisë së Shenjtë, Mishërimi, Shpërblimi, Doktrina e Hirit, e drejtësisë dhe e virutyteve teologjike, Metafizika dhe në mënyrë të veçantë Doktrina e Entit si një substancë sipas modaliteteve të analogjisë dhe të pjesmarjes, Antropologjia, Angjelogjia, Principet e Moralit dhe virtytet e moralit.

Në disa botime të bëra në revista dhe në konferencat e shumta ku ka marrë pjesë, ai ka trajtuar çështje teologjike – filozofike të lidhura me aktualitetin, që përmbanin karakter etiko – social, duke nxjerrë në dritë vlerat kryesore që i ndriçonin dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të njerëzimit të sotëm.

At Tomáš në besnikërinë e tij ndaj hierarkisë së Kishës dhe mësimëve të Konçilit të II^{të} të Vatikanit, mori përsipër t'i trasmetojë brezave të reja principet tradicionale, të qëndrueshme dhe universale, filozofike, etike, rregulltare dhe teologjike të katolikizmit, duke i ilustruar, duke i thelluar dhe duke i shpjeguar me inteligjencën e kulturën e tij që e përparonin më tepër mendimin katolik.

Mendimi i At Tomáš dallohet për pastërtinë dhe ortodoksinë doktrinale: ndaj është një mendim i besueshëm dhe i sigurtë, duke ndjekur atë kemi sigurinë se do të gjendemi në doktrinën më të pasur katolike të cilën ai e ka nxjerrë si nga besimi i tij i shëndetshëm dhe i bindur ashtu edhe nga magjisteri i Kishës, si nga teologët e mëdhenj të së shkuarës dhe të së tashmes ashtu edhe nga shkolla tomiste.

Në dritën e këtyre kriterëve të gjykimit, Shërbëtori i Zotit sheh shumë gabime doktrinale të së shkuarës dhe të së tashmes, duke nxjerrë në pah, ashtu